

Ky nuk është vendi për të rinumëruar kronologjinë e mirënjohur të shpërbërjes që e ka përcjellë referendumin e Sllovenisë në dhjetor të vitit 1990. Siç ka argumentuar edhe Susan L. Woodward, thelbi i shtytjes së SHBA-së për një participim më të madh evropian ka pasur qëllim që të sigurojë përgjegjësinë evropiane për transicionin në Evropën Lindore. Megjithatë, shumëkush ka parë motive më cinike në politikën e SHBA-së, thua se ajo po kërkonte prej evropianëve që të ecin krahu për krahu me të, me shpresë të pamundësisë së tyre për të bërë një gjë të tillë, dhe kësaj kanë shërbyer për një rëndësi në vazhdimësi të liderit të SHBA-së dhe NATO-s. Por vendimi që të përdorin Kombet e Bashkuara për të organizuar kolicionin ushtarak për "Stuhinë e Shkretëtirës" ka qenë edhe më shumë domethënës në pasojat e veta negative për konfliktin jugosllav. Me historinë e gjatë të pjesëmarrjes së Jugosllavisë në Kombet e Bashkuara, lidhjet e saj të shkëlqyera me vendet e Botës së Tretë, dhe mos antarësinë e saj në Komunitetin Evropian (KE) dhe në NATO, Kombet e Bashkuara kanë qenë e vetmja organizatë ndërkombëtare që do të mund ta bënte një ndërhyrje të jashtme dhe me këtë rast të gjitha palët në Jugosllavi do të mund ta pranonin si ndërhyrje neutrale dhe legjitime. Preokopimi i Kombeve të Bashkuara me Irakun dhe përdorimi i Kombeve të Bashkuara që të mbrojnë interesat vitale të sigurisë së SHBA-së kishin dërguar mesazh mjaft të fuqishëm që ndërhyrje e tillë nuk do të mund të ndodhte në Jugosllavi. Për kroatët dhe sllovenët problemi kryesor ka qenë që të bëhen anëtarë të KE-së sa më shpejt që ishte e mundur dhe atë si sllovenë dhe kroatë dhe jo si

## Komuniteti ndërkombëtar dhe ish-Republika e Jugosllavisë (2) Politika e shanseve të humbura (1990 - qershor 1991)

**Përpjekjet e Sllovenisë dhe Kroacisë për pavarësinë fituan një mbështetje të madhe më 13 mars 1991, kur Parlamenti Evropian miratoi një rezolutë ku deklaronte se "republikat kushtetuese dhe provincat autonome të Jugosllavisë duhet të kenë të drejtën e lirë që të përcaktojnë të ardhmen e tyre në mënyrë paqësore dhe demokratike, duke u bazuar në parimet ndërkombëtare dhe kufijtë e brendshëm"**

"jugosllavë". Mund të duket e tejet-thjeshtëzuar por ky ishte mendimi i qarqeve të intelektualëve në Slloveni të cilët ishin tubuar së bashku rreth revistës "Nova Revija". Që të dy qeveritë federale, ajo sllovene dhe ajo kroate, dhe politikanët e tyre kanë kërkuar mbështetje nga institucionet dhe qeveritë evropiane për programet e tyre të ndara.

Më 23 dhjetor 1990, qytetarët e Sllovenisë, dhe, më 19 maj 1991, qytetarët e Kroacisë, votuan për shtete të pavarura me votën e shumicës. Mirëpo përpjekjet e këtyre dy shteteve për të fituar pavarësinë fituan një mbështetje të madhe më 13 mars 1991, kur Parlamenti Evropian miratoi një rezolutë ku deklaronte që

"republikat kushtetuese dhe provincat autonome të Jugosllavisë duhet të kenë të drejtën e lirë që të përcaktojnë të ardhmen e tyre në një mënyrë paqësore dhe demokratike, duke u bazuar në parimet ndërkombëtare dhe kufijtë e brendshëm".

Derisa shumica e qeverive evropiane kishin vazhduar të mbështetnin qeveritë federale dhe të insistojnë që Jugosllavia të jetë një e vetme, kjo në dukje nuk e ka kundërshtuar natyrën e kësaj deklarate, në

bazë të parimeve të Këshillit për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë (CSCE), sipas James Gow demonstroi se sa Sllovenia dhe Kroacia kishin ndikuar në opinionin evropian dhe sa pak gjasa kishte që alternativa e sovranitetit republikan do të mund të vinte në pah, siç potencojë nga Susan L. Woodward.

Ekipi kishte ardhur në përfundim se Sllovenia dhe Kroacia kanë arritur të ndikojnë në opinionin publik evropian, por jo që të arrijnë nivelin që të mos dëgjohej ndonjë alternativë tjetër pos sovranitetit të republikave. Iniciativat pasuese të Evropës dhe SHBA-së, - plani Vance, Plani Cutileiro, plani Vance - Owen, plani Owen - Stoltenberg, plani Z4, etj., kanë qenë të gatshme që në një mënyrë ose në një tjetër të rrezikojnë parimet e sovranitetit të republikave. Siç ka sugjeruar Woodward, ministri i Jashtëm Jugosllav, Budimir Llonçar, e ka parë ndihmën rreth kësaj krize politike në ndërhyrjen e Këshillit të Evropës në vend të SHBA-së, duke shpresuar se kjo do të aktivizojë mbështetjen politike për qeveritë federale që janë pro reformimit evropian dhe të neutralizojë simpatinë për Slloveninë dhe Kroacinë. Çështja është,

megjithatë, nëse Qeveria Federative e Jugosllavisë ishte e sinqertë në synimin e saj pro reformave evropiane. Woodward ka shkruar gjithashtu se Gjermania tashmë iu është bashkuar radhëve të Austrisë, Hungarisë, dhe Danimarkës në të paktën përkrahjen e fshehur dhe inkurajimin e pavarësisë së Sllovenisë dhe Kroacisë. Derisa dëshmitë të tregojnë të kundërtën, ekipi duhet të supozojë se Gjermania (së bashku me Austrinë, Hungarinë, Danimarkën, etj. nuk kanë qenë duke punuar fshehurazi për pavarësinë e Kroacisë dhe të Sllovenisë në fillim të vitit 1991). Madje edhe në fillim të krizës në qershor të vitit 1991, duke iu referuar burimeve të vlefshme, Gjermania nuk ka provuar të mbështesë ndarjen e Jugosllavisë. Gjatë fundit të vitit 1991, megjithatë ishte Gjermania ajo e cila ka bindur Evropën dhe SHBA-në që të njohin Slloveninë, Kroacinë dhe Bosnjë-Hercegovinën. Kjo pikëpamje është përkrahur nga argumentet e bëra nga Micheal Libial, atëherë drejtues në Seksionin Evropian të Juglindjes në Ministrinë e Jashtme gjermane, në librin e tij "Limits of Persuasion" (Kufijtë e bindjes). Ky

libër i bën të qartë lexuesit jo vetëm me ngjarjet e brendshme të pjesëmarrësve në ngjarje, por gjithashtu me analiza shumë të mira historike dhe shkencore. Libial pohon se, megjithëse parlamentarët e Gjermanisë e kanë kërkuar nga Qeveria gjermane njohjen e Sllovenisë dhe Kroacisë në qershor të vitit 1991, Qeveria gjermane është munduar të përdorë kërcënimin e njohjes si metodë të presionit ndaj serbëve të Kroacisë dhe Qeverisë jugosllave që t'i ndër-presin luftimet. Është ininteresante të thuhet se të parët që e kanë kërkuar njohjen ishin socialdemokratët gjermanë, që atëherë ishin në opozitë; por shpejt atyre iu ishin bashkuar edhe demokristianët e partisë qeveritare të kancelarit Kohl. Më 24 gusht 1991 ministri i Jashtëm gjerman, Hans Dietrich Genscher, e kishte thirrur ambasadorin jugosllav në Bonn, Boris Frlec, që të bëjë të qartë qëndrimin e Qeverisë gjermane jo vetëm për të, por edhe përmes një komunikate, për të gjithë opinionin publik. Genscher i kishte dënuar veprimet e paramilitarëve serbë si dhe të ushtrisë serbe si një përpjekje për të ndryshuar kufijtë e brendshëm me forcë dhe si një kërcënim për procesin e negociimit, dhe kishte kërkuar kthimin e Armatës Popullore të Jugosllavisë në kazerma.

(vijon)

Studimi "Komuniteti ndërkombëtar dhe ish-Republika e Jugosllavisë" është përpiluar nga një grup punues prej 20 ekspertësh të ndryshëm ndërkombëtarë dhe nga trevat e ish-Jugosllavisë. Udhëheqës të studimit kanë qenë Matjaz Klemençiq dhe Dushan Janjiq.

**"Rekuiem për një kampion: historia e Mike Tysonit" (10)**

## Kthimi i pamëshirshëm i kampionit

**Meçi filloi. Bruno po përpiquej t'i shmangej luftës direkte dhe merrte vërejtje nga arbitri që të mos kapej. Megjithatë, nja 20-30 sekonda para se të përfundonte rundi i parë, Brunos iu sollën yjet rreth kokës. E kishte marrë një goditje të fortë turinjeve dhe i ishte mbyllur njëri sy. Anglezi, megjithatë, kërkoi ta vazhdonte duelin. Gabim i madh**

Mike Tyson kishte qenë duke u përgatitur për duelin me Evander Holyfieldin, kur u takua me Desiree Washingtonin më 1991. Ky takim i kushtoi me tre vjet të kaluara në burg.

Tani, më 1995, Mike Tysoni po përgatitej sërish për t'iu kthyer ringut, edhe një herë duke e pasur në mendje Evander Holyfieldin. Mirëpo, para Holyfieldit, atij i duhej të rrahej me disa boksiere më pak të njohur, sa për të parë nëse Tysoni në burg ka stërvitur apo vërtet ka lexuar libra, siç pohonin menaxherët e tij. "Kur isha në burg më fushnin ndër ato rafte me gjithë ata libra të trashë. Ato pallavra të Tolstoyit. Njerëzit nuk do të duhej të lexonin budallallëqe të tilla", thoshte Tyson.

Meçi i tij i parë pas daljes nga burgu po bëhej gati. Në mejdan po i dilte Peter McNeeley. Salla në Las Vegas ishte e mbushur plot në mbrëmjen e 19 gushtit të vitit 1995. Populli kishte dalë për të parë se çfarë kishte mbetur nga Mike Tysoni.

Populli do të mund të zhgënjhej vetëm për një gjë: i kishte dhënë

gjithë ato para vetëm për 89 sekonda. Aq kohë i mjaftoi Mike Tysonit për ta hedhur në dysheme McNeeleyn.

"Gjëmonte si gruaja ime në shtrat", thoshte Tysoni më pas. Më 16 dhjetor të të njëjtit vit, Tyson e kalon edhe provën e dytë. Buster Mathis rrëzohet në rundin e tretë dhe ia hap ish-të burgosurit udhën e titullit të kampionit.

Lufta për titullin e kampionit në kategorinë e rëndë në versionin WBC do të zhvillohej në sallën "Medison Square Garden" në New York. Karshi Tysonit do të dilte Frank Bruno, një boksiere britanik. Mirëpo, adhuruesit e boksit në atë mbrëmje të 16 marsit 1996 nuk kishin ardhur në sallë për ta parë Brunon. Bruno do të mbetej vetëm si një fusnotë.

Populli donte ta shihte Mike Tysonin tek po e kthente titullin e kampionit të botës. Secili dëshironte të ishte dëshmitar në vendin e ngjarjes të kësaj ngjarjeje të madhe të boksit.

Mike Tysoni në atë ndërkohë e kishte veten në qejf.

"Medison Square Garden do të mbushej edhe vetëm po të dilja

unë të masturboja", thoshte ai. Frank Bruno e kishte fituar titullin e kampionit në WBC gjashtë muaj më parë, kur në një duel heroik e kishte rrahur në Londër Oliver McCallin. Tysoni ishte sfiduesi i tij i parë. Bruno e njihte shumë mirë Tysonin. Ishte matur me të njëherë më 1988. Në dy rundet e para anglezi kishte qenë më i mirë, por e kishte marrë një kroshe në rundin e pestë dhe kishte nisur t'i numëronte yjet. Mirëpo, këtë herë Bruno shpresonte për më shumë. Gjithçka ishte gati.

Meçi filloi. Bruno po përpiquej t'i shmangej luftës direkte dhe merrte vërejtje nga arbitri që të mos kapej. Megjithatë, nja 20-30 sekonda para se të përfundonte rundi i parë, Bruno i pa yjet edhe një herë. Gjysmë pa vetëdije kërkoi që dueli të vazhdonte.

Në rundin e dytë edhe bëri ballë. Mirëpo, më mirë të mos kishte vazhduar më. Në rundin e tretë, Tysoni e kapi me një kombinim prej 5 goditjesh rresht dhe Bruno ra për dysheme. Gjaku i shkante lumë mbi sy.

Tysoni e ktheu titullin e kampi-



onit në WBC. Për Brunon ky ishte dueli i fundit profesionist në karrierë.

Lëndimet e pësuar në këtë duel kishin qenë shumë të rënda. Pas disa operacionesh, mjekët ia ndaluan marrjen aktive me boksi. Kishte rrezik të humbiste të parët. Tani Tysoni kërkonte edhe titullin tjetër - në WBA.

Kundërshtari i tij ishte kampioni i këtij versioni, Bruce Seldon. Më 7 shtator 1996 bota do ta shihte edhe një herë Tysonin në aksion. Bota kishte çka të shihte.

Bruce Seldon nuk e kishte përsëritur gabimin e Frank Brunos. E kishte marrë një grusht të fortë në rundin e parë dhe nuk ishte ngritur më, derisa arbitri

kishte numëruar deri në dhjetë. Mike Tysoni i kishte kthyer dy nga tre titujt e tij të kampionit. E donte edhe të tretin dhe bashkë me të e donte edhe zemrën e Evander Holyfieldit.

"A e di çka po të pret, more?! Do të kënaqem me ty", porosiste Mike Tysoni.

Gjithë karrierën kishte dhënë deklarata të ngjashme, për t'i tmerruar kundërshtarët. Evander Holyfieldi e kishte dëgjuar deklaratën e Tysonit. Vetëm kishte buzëqeshur.

**(Në numrin e ardhshëm: Duelet e Mike Tysonit me Holyfieldin dhe me Lennox Lewisin)**